



KOMUNA E KLINËS
KLUVENDI I KOMUNËS
01. NR. 06-4762/17
KLINË, 28.7.2017

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I SEANCËS SË VII-të TË KK, MBAJTUR, MË 28.7.2017, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E
KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, Enver Berisha, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, zv. komandanti i Policisë, Engjëll Prenaj, anëtarët e KK, drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, KFOR-i, OSBE, OJQ “Koha” etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë seancë të KK-së. “Materialin bashkë me rendin e propozuar të ditës se keni marrë me kohë, hapi debatin rreth rendit të ditës.

Haxhi Ibishi, tha se materialin bashkë me rendin e propozuar të ditës se keni marrë me kohë, hapi debatin rreth rendit të ditës.

Skënder Merturi, tha se kam propozim që si pikë e veçantë e rendit të ditës të futet edhe çështje e lirimit nga pagesa e tatimit të bizneseve të cilat janë të prekura nga rregullimi i sheshit, duke përjashtuar bankat, Postën dhe KEDS-in. “Pra kjo çështje të futet si pikë e fundit e rendit të ditës”, pohoi anëtari Merturi.

Haxhi Ibishi, sqaroi që kërkesa e ngritur nga anëtari Merturi është e përfshirë brenda rendit të ditës, te pika e IV-të.

Arben Limani, ngrehu çështjen e punimeve të sheshit me kubëza. “Nga disa banorë të lagjes kemi marrë informacione se kanë filluar punimet në rregullimin e sheshit me kubëza. A mund të na jepet një përgjigje, ngase nuk jemi ekspertë, pra ndokush të na sqarojë, a është vlerësuar cilësia e atyre kubézave që po vendosen aty”, ka shtuar anëtari Limani.

Haxhi Ibishi, sqaroi se në fund të seancës do të jepet përgjigja.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës.

Me 25 vota u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar – qershor 2017 (Ref. drejtorja e FEZH),
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Ref. Drejtorja e FEZH),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për vënien në diskutim publik Draft-rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre (Ref. Zyra ligjore),
6. Shqyrtimi i Procesverbalit të Takimit me Qytetarë për periudhën gjashtëmujore të vitit 2017,
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të përgjithshëm për vitin 2016 të Raportit Financiar vjetor të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se ka dy arsye rreth mungesave, të anëtarit Ramush Agushi dhe Avni Gashi.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar – qershor 2017 (Ref. drejtorja e FEZH).

Haxhi Ibishi, foli rreth Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar – qershor 2017. Kryesuesi falënderoi drejtorin e Drejtorisë së FEZH për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe shumë korrekt me Kuvendin e Komunës përgjatë gjithë këtyre viteve.

Në vijim kryesuesi për raportim fjalën e barti te drejtori i FEZH, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta referoi rreth Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar – qershor 2017.

“Edhe në KPF kemi debatuar, edhe këtu po prezantojmë një raport financiar për periudhën gjashtëmujore janar – qershor 2017. Materialin e keni marrë me kohë. Përpara i keni parametrat e gjashtë mujorit të parë për këtë vit. Ndryshimi në këtë periudhë krahasuar me vitin e kaluar është më i lartë për 3.64 për qind. Buxheti i shpenzuar në periudhën janar –qershor 2017 në vlerë 3,849,907.46 € është 42.51 % e buxhetit në SIMFK për gjashtëmujorin 2017. Nga Granti qeveritar 3,652,572.65 € (47.96 % në raport me buxhetin nga Granti), nga të hyrat vetanake 117,261.79 € (11.38 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2017), nga të hyrat e bartura 26,190.09 € (7.97% në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga donacioni i Save the Children 4,664.93 € (82.48% në raport me buxhetin nga ky donator) dhe nga donacioni i Qeverisë Japoneze 49,218.00 € (71.14% në raport me buxhetin nga ky donacion) . Ndërsa, nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 3,849,907.46 € nga granti qeveritar janë 94.87% , nga të hyrat vetanake 3.05 % , nga të hyrat e bartura 0.68 % , nga donacioni i Save the Children 0.12% dhe nga donacioni i Qeverisë Japoneze 1.28 % .Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta për rreth 3.75 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – qershor 2017 në vlerë 3,849,907.46,€ për paga dhe, mëditje janë shpenzuar 2,829,327.51 € (73.49% e shpenzimeve), për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 273,692.66,€ (7.11% e shpenzimeve), për shërbime komunale 8,430.91 € (2.09% e shpenzimeve), për subvencione 45,279.20 ,€ (1.18 % e shpenzimeve) dhe për kapitale 621,177.18 € (16.13 % e shpenzimeve). Shpenzimet në periudhën janar-qershor 2017 në vlerë 3,849,907.46 € krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në vlerë 3,710,766.01 € janë rritë për rreth 3.75 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë zvogëluar 0.11 % , shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 9.77 % , shpenzimet për shërbime komunale janë zvogëluar për 9.32 % , shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 2.08 % dhe shpenzimet për kapitale janë rritë për rreth 41.20 % . Totali i përgjithshëm është 3,849,907.46 euro”, theksoi drejtori Rrusta, i cili në vijim sqaroi edhe shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë rreth raportit. “Këtu sot kam sjellë edhe raportin e subvencioneve, nga kanë shkuar mjetet të dedikuara për këtë kategori të shpenzimeve. Te krahasimi i të hyrave eventuale e kemi një krahasim të tillë. Jemi të gatshëm t’ju përgjigjemi pyetjeve tuaja”, pohoi ndër të tjera drejtori Rrusta.

Arben Limani, tha se disa prej shpenzimeve si grup parlamentar i LDK-së i kemi përmendur në seancat e kaluara. “Për shpenzimet e luksit, për atë rënie të tyre i kemi vlerësimet pozitive, po që se nuk do të dal asgjë në pjesën e dytë të vitit. Pyes drejtorin e Financave rreth shpenzimeve të detajizuara, është dhënë raporti për gjashtëmujorin. Të detajizohen shpenzimet e vitit 2016. T’i kemi pak më të qarta shpenzimet që janë bërë në vitin 2016”, theksoi anëtari Limani i cili në vijim theksoi: “ Desha një sqarim , te kategoria e subvencioneve dhe transferove”, pohoi anëtari Limani, i cili foli edhe për disa çështje tjera tematike.

Tunë Dedaj, foli rreth çështjes në debat. “më ranë në sy disa shpenzime të tepërt, si shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, shpenzimet për telefona, ku

shumë është e madhe. Po ashtu, pohoi anëtari Dedaj, vlera e shpenzimeve është tepër e madhe”, tha anëtari Dedaj.

Vlora Tafili, foli rreth çështjeve në shqyrtim. “Te kodi ekonomik shifra po arrin deri në 22 mijë euro. Po i kemi të njëjtat shpenzime sikur brenda viteve paraprake”, pohoi ndër të tjera anëtarja Tafili.

Ramiz Rrusta, iu përgjigj interesimeve të ngritura nga ana e anëtarëve rreth raportit të menaxhimit financiar. Drejtori Rrusta sqaroi çështjen e shpenzimeve të subvencioneve dhe potenciale emrat e shfrytëzuesve të subvencioneve, po ashtu edhe arsyet e ndarjes së këtyre mjeteve për këtë kategori. Në vijim drejtori sqaroi rastin e veturës së auto-ambulancës, e cila është donacion i qeverisë japoneze dhe shfrytëzohet nga QKMF në Klinë. Rreth shpenzimeve brenda vendit, ku këto shpenzime janë të dedikuara për udhëtimin e nxënësve me nevoja të veçanta. Drejtori po ashtu sqaroi edhe shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit dhe arsyetoi shpenzimet dhe siç pohoi drejtori “mund t’ju sjell kush ka shkuar jashtë vendit dhe qëllimin e shkuarjes. Drejtori Rrusta, po ashtu pohoi se janë reduktuar shpenzimet në të gjitha kategoritë.

Fadil Gashi, tha se e falënderoj drejtorin e Financave për bashkëpunimin që ka pasur gjatë këtyre viteve me Kuvendin dhe KPF-në. “Çka na bëri përshtypje në raport regjistri i subvencioneve. Çka ka pasur nevojë për të shkuar me subvencion te festivali “I këndojmë lirisë?! “Subvencion” domethënë “ndihmë”. Nëse ne i kemi dhënë paratë për festivalin, nuk jam duke mundur për ta kuptua, pse këto mjete të subvencioneve të ndahen për festivalin?”- shtoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Skënder Merturi, ngriti disa çështje rreth shpenzimeve. “Të na sqarohet se Zyra e kryetarit, shpenzimet në shumë prej 38 mijë për paga, sa punëtorë i ka Zyra e Kryetarit; shpenzimet për derivate te Zyra e Kryetarit, për këto e dimë sepse ai jeton në Prishtinë; Zyra e Kryetarit, mallra dhe shërbime, edhe këtu shuma është prej 12 mijë euro; te subvencionet është e pakuptimtë që janë ndarë mjete edhe për Festivalin i”I këndojmë lirisë”, qysh janë ndarë subvencione për këtë festival kur dihet që Kuvendi ka ndarë shumë prej 20 mijë euro. Drejtoria e Financave ka qenë drejtoria më korrekte në aspektin e bashkëpunimit edhe me KPF-në, po ashtu edhe me Asambleenë komunale. Mendimin për kryetarin nuk e ndryshoj”, pohoi anëtari Merturi.

Ramiz Rrusta, sqaroi çështjet e ngrehura nga anëtarët e Kuvendit. “Ju falënderoj të gjithëve. Kam bërë përpjekje që të jem korrekt. Jeni të barabartë të gjithë dhe mendimet i cilitdo i respektoj”, pohoi drejtori Rrusta, i cili në vijim sqaroi dhe arsyetoi shpenzimet e Zyrës së Kryetarit. “Subvencionet që kryesisht janë ndarë për shërim, po ashtu për festival ka kaluar në shumë prej 1 mijë euro, po ashtu edhe për klubet sportive “Dukagjini”, e kapin këtë shumë që figuron në tabelar. Vendimi është te Zyra ligjore as kryetari nuk kishte mundur për të vendosur”, sqaroi ndër të tjera drejtori Rrusta.

Sokol Bashota, foli rreth çështjes në debat. “Nuk ka kod tjetër për subvencionet. Të gjitha shpenzimet i janë nënshtruar konkurrencës tenderuese. Edhe kërkesat për shëndetësi janë në

këtë shumë. Është shumë mirë që e mbyllim këtë gjashtëmuor me këtë sukses”, konstatoi kryetari Bashota.

Kryesuesi Ibishi vuri në miratim Raportin e menaxhimit Financiar për gjashtëmuorin e parë të vitit 2017.

Me 14 vota për, 6 kundër, 4 abstenime u miratua Raporti i menaxhimit financiar komunal për periudhën janar – qershor 2017.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Ref. Drejtoria e FEZH).

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjen në rend të ditës. “Janë bërë të gjithë hapat deri në vendimmarrje sot”, pohoi kryesuesi.

Miftar Krasniqi, zyrtar i Financave, sqaroi rreth çështjes në shqyrtim, përkatësisht rreth ndryshimeve në këtë rregullore.

“Në KPF kemi pasur dilema rreth zonave. Është kërkuar që të shtohet edhe një zonë, të bëhen 4 zona. Nëse pajtoheni të bëhet një lirim prej 9 për qind për të gjithë fshatrat. Për kategoritë tjera mbesin kështu. I kemi paraparë zonat”, theksoi zyrtari Krasniqi, i cili në vijim sqaroi edhe sërë çështjesh tjera rreth rregullores gjegjëse.

Haxhi Ibishi, theksoi se është propozim të krijohet zona 4, shtoi kryesuesi, i cili në vijim hapi diskutimin rreth çështjes në shqyrtim.

Ndue Shabanaj, foli rreth çështjes në shqyrtim. Anëtari Shabanaj, theksoi se ky propozim është e rrugës që të ketë një sqarim me të thukët. “Arsyeshmërinë e dimë mirë. Ngritja e tatimit të një zone duhet ta ketë arsyeshmërinë bindëse të ngritjes për këtë zonë”, pohoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

Skënder Merturi, theksoi se edhe në debat me publikun kam theksuar që të shtohet zona 4. “Kjo asamble të merr vendim për lirimin e bizneseve për 2 vite prej tatimit në biznes për këto kategori të biznesit të cilat janë të prekura nga rregullimi i sheshit.

Haxhi Ibishi,sqaroi çështjen e ngrehur. “Ligji i precizon të gjitha gjerat”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Arben Limani, tha se në takimin e parë në zyrën e drejtorit ishte një propozim që të jetë 250 euro, a ka mbetur i pandryshuar?- theksoi anëtari Limani.

Tunë Dedaj, theksoi se mendoj që nuk është zgjidhje rritja e tatimit, mirëpo qenësore është që t’iu merren borxhet atyre s’i kanë paguar. “Po ju rrisim atyre që paguajnë, ndërkaq po i lirojmë ata që nuk paguajnë. Disa lokale në shesh po funksionojnë mirë. Nuk mund t’i ndash lokalet”, shtoi anëtari Dedaj.

Skënder Merturi, theksoi se propozimi është opër taksë komunale, jam kundër rritjes në qendër, të shtohet zona 4, për t'u liruar prej taksës komuinale.

Rasim Millaku, foli rreth çështjes në debat. “neni 6, pika 4, pse për ta tatimuar këtë kategori. Neni 10, kjo është e paarsyeshme. Nëse një biznes nuk bënë afarizëm pse të tatimohet?”- pohoi anëtari Millaku.

Miftar Krasniqi, iu përgjigj interesimeve të anëtarëve rreth rregullores në shqyrtim.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në debat.

Ramiz Rrusta, sqaroi disa çështje rreth tatimit të pronave.

Fadil Gashi, theksoi se për ato që janë funksionale duhet të tatimohen. “Përderisa Komuna i ka regjistruar funksionale doemos duhet të tatimohen, ndërkaq po që se s’janë funksionale, atëherë të mos tatimohen. Te shtëpitë, le të regjistrohen, mirëpo ato të cilat janë të pabanueshme të lirohen. Nëse nuk është e banueshme të mos regjistrohet”, theksoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi që bilanci po mbetet i njëjtë.

Ndue Shabanaj, foli rreth çështjes në debat. “ Në momentet kur ngritet shkalla e tatimit, është e ndjeshme, sado e vogël të jetë. Ka kategori që s’ka asnjë burim të ekzistencës”, shtoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

Miftar Krasniqi, sqaroi rreth çështjes në debat.”Ne nuk mund ta lirojmë askënd po që se nuk e liron ligji”, sqaroi zyrtari Krasniqi.

Fadil Gashi, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Përderisa një shtëpi 3 kate, nëse 2 kate janë të banueshme, kati i 3 është i pabanueshëm, të mos regjistrohet ai kat, pasi që në atë kat nuk banon askush. Të tatimohet ajo pjesë që është e shfrytëzueshme, përkatësisht e banueshme, e jo ajo që është e pabanueshme, pasi që aty nuk banon askush. Ta gjejmë një zgjidhje rreth kësaj çështjeje”, shtoi ndër të tjera anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim Draft-rregulloren.

Me 24 vota për, 1 abstenim u miratua draft-rregullorja.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për vënien në diskutim publik Draft-rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre (Ref. Zyra ligjore).

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Hapi debatin. Nga ana e anëtarëve nuk pati debate. Vuri në miratim propozimin për vënien në diskutim publik të draft-rregullores.

Me vota unanime (25), pa kundër dhe pa abstenim u miratua propozimi për vënien në diskutim publik të Draft-rregullores.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi i procesverbalit të Takimit me qytetarë për 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e Takimit me qytetarë për 6-mujorin e parë të vitit 2017.

Me vota unanime u miratua procesverbali.

Pika e shtatë: Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të përgjithshëm për vitin 2016 të Raportit Financiar vjetor të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes. Hapi debatin.

Vlora Tafili, foli rreth çështjes në shqyrtim. “Kemi probleme të mëdha të menaxhimit”, shtoi ndër të tjera anëtarja Tafili.

Arben Limani, foli rreth çështjes së raportit të auditimit. “Auditori i Përgjithshëm ka konstatuar shumë lëshime. Desha për të përmendur një shqetësim si grup kur është miratuar plani i prokurimit. Si grup si vërejtje kemi çështjen e furnizimit me artikuj ushqimorë, një thes miell 2.5 euro, 1 kg kafe 1 euro!”, shtoi anëtarja Limani, i cili në vijim potencoi edhe disa lëshime të tjera që janë evidencuar në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm.

Fadil Gashi, tha se kam thënë se nuk pajtohem me këtë çmimore. “Ka dalë absurd, mielli 40 cent, apo 1 kg kafe 1 euro! Auditori ka bërë gjetje vetëm në këta dy artikuj. Prej krejt këtij raporti kryetari duhet për të qenë në nivel të përgjegjësisë, sepse është menaxhuesi kryesor. Gjithë adresimi i bëhet kryetarit. Pra, përgjegjësia i bie direkt kryetarit”, pohoi anëtarja Gashi, i cili në vijim foli edhe për disa lëshime të tjera.

Sokol Bashota, tha se jemi duke punuar, prandaj ka edhe të gjetura. “Raportin unë e kam qitë në Asamble komunale. Të gjithë drejtorët i kanë marrë vërejtjet e mia. Punën time e kam kryer si menaxher dhe besoj se gjithsesicili është përgjegjës”, ka pohuar ndër të tjera kryetari Bashota.

Baki Gashi, sqaroi çështjen e projekteve të kanalizimit në Budisalc. “Vonesat kanë qenë të arsyeshme. Kontrata është nënshkruar në dimër”, ka sqaruar drejtori Gashi.

Abaz Foniqi, zyrtar i Zyrës së Prokurimit, sqaroi vërejtjet të paraqitura në Raportin e Auditorit të përgjithshëm. “Shqetësimet janë me vend. Si çmime janë të ulëta. Ligji i ka disa kriterë. Ky raport është shumë i përgatitur mirë, adresohen në nivele të gjitha përgjegjësive. Kemi pranuar një çmim që nuk shkon në dëm të buxhetit të Komunës”, ka sqaruar ndër të tjera zyrtari Foniqi.

Fadil Gashi, foli rreth çështjes tematike. “Vërejtjet janë publike. Nuk është duke na përmendur ato që janë më të larta. Ligji të ka dhënë mundësitë për t’i parë situatat. Ai të sjell kafen, mirëpo

duhet vlerësuar çfarë është cilësia. Po që së malli nuk është cilësor, nuk ia vlen të ta marrësh. Duhet disiplinuar operatorët ekonomikë”, ka shtuar ndër të tjera anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se i kemi kuptuar lojërat e operatorëve. “Ligji nuk na lejon mos me ia dhënë atij që i plotëson kriteret”, shtoi kryetari.

Fadil Gashi, sërish foli rreth çështjes tematike.

Sokol Bashota, pohoi se në prokurim caktohen nevojat.

Skënder Merturi, foli rreth çështjes në debat, përkatësisht ngrehu sërë vërejtjesh rreth çështjes së caktuar.

Sokol Bashota, tha se është qytetari ai që vendos, le t’i mbetet kohës. “Jemi në fund të mandatit të tretë, po përgatitemi për mandatin e katërt. Sukseset në përgjithësi i adresohen subjektit e jo individit. Shkojnë në prokurori dhe pyetni si jemi dalë me të gjeturat. Ju ka ardhur turp që janë marrë me ato. Këto nuk e degradojnë imazhin e askujt”, ka konstatuar kryetari Bashota.

Vlora Tafili, foli rreth çështjes në debat.

Baki Gashi, sqaroi se cilësia e kubëzave e gurit janë të cilësisë së lartë, është një organ që mbikëqyr.

Haxhi Ibishi, uroj Violeta Zefin për titullin e doktoraturës së shkencave të psikologjisë.

Violeta Zefi, falënderoi kryesuesin për urimin.

Kryesuesi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI

